

Granti i Arsimit për komunitatet e Kosovës për vitin 2016 është rritur për 10 milion euro



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim dymujor • Viti XII • Nr.71 • Mars - Prill 2015

Asociacioni i Komunave të Kosovës takoi partnerët e qeverisjes lokale

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takim të rregullt me partnerët e saj në takimin “Miq të AKK-së” në Prishtinë, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me partnerët të përfshirë në aktivitetet dhe projektet e qeverisjes lokale në Kosovë.



Hartohet model - dokumenti për klasifikimin e vendeve të punës për shërbyesit civil në nivelin lokal



Nis projekti regional “Eficienca e Energjisë në Asociacionet e Komunave”

Asociacioni i Komunave të Kosovës takoi partnerët e qeverisjes lokale

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takim e rregullt me partnerët e saj në takimin "Miqhtë e AKK-së" në Prishtinë, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me partnerët të përfshirë në aktivitetet dhe projektet e qeverisjes lokale në Kosovë.

Në këtë takim ku morën pjesë përfaqësuesit e dhjetëra partnerëve dhe mbështetësve të AKK-së por edhe të Komunave të Kosovës si dhe kryesuesit e Kolegjiumeve Profesionale të AKK-së fjalën hapëse e mbajti z.Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK. Ai më pas njoftoi të pranishmit në pika të shkurtra për natyrën dhe qëllimin e takimit, theksoi rolin e veçantë dhe rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët në projekte të ndryshme në interes të komunave bëri prezantimin e të arriturave dhe punës së deritanishme të AKK-së në vitet e fundit si dhe raportin e punës 2014 si dhe me planin vjetor për vitin 2015.

Drejtori i AKK-së z.Sazan Ibrahim paraqiti para të pranishmëve objektivat e Asociacionit të Komunave të Kosovës për vitin 2015 në lobim dhe mbrojtje të interesave të Komunave të Kosovës si dhe synimet për angazhime dhe aktivitete të të



gjitha strukturave të AKK-së. Nga shumica e pjesëmarrësve u paraqitën projekte e tyre konkrete në fushat e ndryshme ku mund të ketë bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta së bashku me komunat në realizimin e objektivave të qarta të cilat kanë gjatë mandatit të tyre këto organizata. Sigurisht njëra ndër sfidat ende mbetet bashkëpunimi më i mirë nga donatorët në fusha të ndryshme gjatë zbatimit të projekteve të tyre andaj edhe bashkëveprimi i aktiviteteve duhet të jetë në funksion të organizimit sa më të mirë të punës, në mos dyfishimin e aktiviteteve dhe projekteve nga partnerët të ndryshëm. Po ashtu

kërkuar qasje më aktive dhe bashkëfinansim të projekteve në fjalë nga komunat lidhur me aktivitetet e përbashkëta në përmirësim të shërbimeve për qytetarët në fusha të ndryshme.

Kryesuesit e Kolegjiumeve e çmuan angazhimin e donatorëve në dhënien e ndihmës financiare dhe profesionale për komunat, po ashtu u shpreh përkrahja e fuqishme dhe bashkëpunimi i ngushtë nga Kolegjiumet Profesionale me donatorët sa i përket koordinimit të projekteve në fusha specifike, bashkërendimi i planeve të punës dhe aktiviteteve në zbatimin me sukses të tyre në teren.

Granti i Arsimit për komunitat e Kosovës për vitin 2016 është rritur për 10 milion euro

Është mbajtur takimi i Komisionit të Granteve për procesin e planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2016, e ku kanë marrë pjesë edhe kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli dhe kryetari i Mitrovicës z.Agim Bahtiri e kryetari i Komunës së Kamenicës z.Begzad Sinani. Në këtë takim Komisioni i Granteve në mënyrë unanime miratoi grantin e përgjithshëm, grantet specifike për arsim parauniversitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave dhe transferet për kompetencat e deleguara. Vlen të ceket se për Grantin e Arsimit për komunitat e Kosovës për vitin 2016 është rritur për 10 milion euro dhe do të jetë një ndihmesë e mirë për Komunat e Kosovës.



ARDA organizon punëtori me donatorë me synim të rritje së mbështetjes për zhvillim rajonal



Asociacioni i Agjencive Rajonale për Zhvillim (ARDA) ishte nikoqire e punëtorisë me donatorë mbi zhvillimin socio-ekonomik për rajonin e Lindjes, e cila solli në një vend aktorët dhe hisedarët kyç të zhvillimit ekonomik rajonal dhe përfaqësues nga komuniteti i donatorëve. Pjesëmarrësit u zotuan për një angazhim të shtuar në mbështetje të zhvillimit rajonal edhe për faktin e orientimeve programore të qeverisë për zhvillim ekonomik të cilat i japin një vend të veçantë zhvillimit të politikave rajonale, identifikimit dhe përgatitjes e projekteve me ndikim pozitiv ekonomik, dhe mobilizimit të fondeve të donatorëve.

Kryetarët dhe zyrtarë të lartë të njëmbëdhjetë komunave të rajonit (Gjilan, Ferizaj, Viti, Kamenicë, Kaçanik, Han i Elezit, Novobërdë, Shtërpçë, Ranillug, Partesh dhe Kllokot) patëm mundësinë që të paraqesin 16 projektet më prioritare, si në nivel lokal ashtu edhe regjional. Shefi i Sektorit të Bashkëpunimit në Zyrën e BE-së në Kosovë z. Kristof Stok tha se kjo punëtori është “një mundësi e mirë për thithjen e fondeve për projektet e prezantuara që kanë për qëllim avancimit e zhvillimit rajonal”, duke shtuar se Zyra e BE-së në Kosovë do të vazhdojë të mbështesë projektet sektoriale.

Mbi rëndësinë e zhvillimit rajonal në kuadër të punimeve të punëtorisë folën kryetari i asociacionit të Komunave të Kosovës, kryetari i komunës së Ferizajt dhe kryetari i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal Lindje z. Muharrem Sfarça, kryetari i komunës së Gjilanit, z. Lutfi Haziri, Ministrja për Tregti dhe Industri znj. Hykmete Bajrami, zëvendës ministri për Integritet Europian z. Ramadan Ilazi, dhe në emër të nikoqirit të kësaj ngjarje znj. Valbona Tahiri.

Kjo ngjarje u organizua në partneritet me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Ministrinë e Integritet Europian në Kosovë. ARDA është një rrjet i pavarur jo-qeveritar i themeluar nga pesë Agjencitë për Zhvillim Rajonal, me misionin e koordinimit dhe promovimit të zhvillimit rajonal dhe rural në Kosovë.

Punëtori të ngjajshme rajonale janë organizuar edhe në rajonet tjera të Kosovës me pjesëmarrjen e komunave respektive.

Nis projekti regional “Eficienca e Energjisë në Asociacionet e Komunave”

Në zyret e AKK-së u mbajt takimi i parë në kuadër të projektit “Eficienca e Energjisë në Asociacionet e Komunave” - projekt regjional, i cili përfshin të gjitha Asociacionet e Komunave të vendeve të Evropës Juglindore.

Ky projekt, i cili përkrahet nga GIZ-i, ka për synim hartimin e Planeve të Veprimit për Energji të Qëndrueshme (SEAP). Në Kosovë, SEAP-i do të hartohet për tri komuna të Kosovës: Prishtinë, Gjilan, dhe Podujevë. Me hartimin e planeve SEAP, tri komunave të Kosovës iu hapet rruga për anëtarësimin e tyre në Konventën e Kryetarëve me seli në Bruksel, e cila është një lëvizje e autoriteteve lokale dhe regjionale në Evropë, ku vullnetarisht zotohen për rritjen e efikasitetit të energjisë, përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit në territoret e tyre. Në takim kanë marrë pjesë ekspertë ndërkombëtar dhe lokal si dhe përfaqësuesit e tri komunave të Kosovës që do të përfitojnë nga ky projekt.



Shkurtimisht

■ Përfaqësuesi i AKK-së, mori pjesë në Konferencën me donatorët për turizëm, organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Divizioni për Turizëm.

■ Takimi me Kryesinë e Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor dhe Kryesinë e Kolegjiut të Zhvillimit Ekonomik për diskutimin rreth Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Hartohet model - dokumenti për klasifikimin e vendeve të punës për shërbyesit civil në nivelin lokal



Asociacioni i Komunave të Kosovës, organizoi punëtor tri ditore për hartimin e model- dokumentit për klasifikimin e vendeve të punës për shërbyesit civil të nivelit lokal.

Komunat janë të obliguara që ta bëjnë standardizimin e titujve dhe përshkrimin e vendeve të punës deri më 17 prill 2015. Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), formoi Grupin Punues për të punuar një model se si kishin mundur të klasifikohen vendet e punës. Ky dokument i përgatitur iu është shpërndarë të gjitha komunave, të cilat më pastaj do ta përshtasin sipas specifikave të vendeve të punës që i kanë aktualisht. Grupi punues ishte i përbërë prej nëntë anëtarëve, nga menaxherët e personelit, zyrtarët ligjor, një Drejtor i Qendrës për Punë Sociale, përfaqësuesit e Ministrisë së Administratës Publike

Katalogu i vendeve të punës

Ministria e Administratës Publike, ka miratuar Katalogun e vendeve të punës dhe disa dokumente përcjellëse, të cilat i'u ka shpërndarë të gjitha institucioneve të nivelit qendror dhe lokal. Grupi Punues i AKK-së ka punuar një model se si kishin mundur të klasifikohen vendet e punës. Vlen të ceket se pagat nuk do të ulen, por do të sistemohen aty ku duhet, që në të ardhmen mos të ketë diferencë në pagë të titujt e njëjtë, si në nivelin lokal dhe në nivelin qendror si dhe mes komunave të gjithë titujt e punës të jenë të graduar njëjtë. Po ashtu titujt që nuk janë të përfshirë në Katalog ne i kemi propozuar të përfshihen.

(MAP) dhe të AKK-së. AKK-ja gjatë punëtorisë nga përfaqësuesit e MAP-it ka potencuar dy çështje të rëndësishme që pret të realizohen, (1) që në të ardhmen mos të ketë diferencë në pagë tek titujt e njëjtë mes nivelit lokal dhe nivelit qendror si dhe (2) mes komunave të gjithë titujt e njëjtë të jenë të graduar njëjtë. Po ashtu grupi punues ka propozuar rreth tridhjetë titujt të vendeve të punës, të cilët ekzistojnë nëpër komuna, e që në Katalog nuk janë përfshirë.

Po ashtu AKK-ja do ta organizojë edhe një takim të përbashkët me menaxherët e personelit dhe përfaqësuesit e MAP-së, që sa me mirë të i qartësohet gjitha dilemat e mundshme.

MAPL publikoi raportin për funksionimin e Komunave për vitin 2014

Konform mandatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, publikoi raportin për Funksionimin të Komunave të Kosovës, për vitin 2014. Zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Bajram Gecaj tha se komunat e Kosovës kanë mbajtur gjithsej 472 mbledhje dhe kanë miratuar 2030 akte nënligjore të cilat ndikojnë në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me legjislacionin për vetëqeverisje lokale si dhe ligjet sektoriale që kanë ndikim në vetëqeverisjen lokale. Gjatë miratimit të akteve, Zëvendësministri Gecaj tha se MAPL-ja ka vlerësuar se 52 akte të komunave nuk kanë qenë në pajtim

të plotë me ligjin dhe ka kërkuar nga komunat të ndërmarrin veprimet për harmonizimin e tyre dhe deri tani janë harmonizuar 35 prej tyre, ndërsa MAPL është duke punuar ngushtë me autoritetet lokale që të sigurojmë harmonizimin e akteve tjera, të cilat ndërlihen me menaxhimin e pronës komunale, themelimin e ndërmarrjeve publike, miratimin e buxheteve, miratimin dhe ndryshimin e statuteve komunale, rregulloreve lokale dhe fusha të tjera. Lidhur me përmbushjen e obligimeve nga ana e komunave për procesin e integritimit Evropian, Zëvendësministri Gecaj tha se gjatë vitit 2014 komunat e Kosovës kanë arritur progres në zhvillimin e buxheteve komunale duke konsultuar

qytetarët dhe grupet e interesit, kanë themeluar njësitë e kontrollit të brendshëm, si dhe kanë ndërmarr veprimet konkrete për inventarizimin e pasurisë, kanë zhvilluar programe që lehtësojnë ofrimin e shërbimeve dhe shkurtojnë kohëzgjatjen e pranimit të këtyre shërbimeve. Sekretari i përgjithshëm i MAPL-së, z. Besnik Osmani tha se rekomandimet dhe konkluzionet e raportit të monitorimit të komunave janë të orientuara në tri fusha që kërkojnë angazhim të mëtejshëm dhe që kanë të bëjnë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kuvendet Komunale dhe Kryetarët e Komunave.

Takimi me Komisionin parlamentar për pushtet lokal

AKK-ja, zhvilloj takim pune me Komisionin Parlamentar për Pushtet Lokal, me të cilën e diskutuan agjendën legjislative dhe u dakorduan për vazhdimin e bashkëpunimit që përfaqësuesit e AKK-së të ftohen në takimet e këtij komisioni, kur shqyrtohen projektligjet që ndërlidhen me kompetencat e autoriteteve lokale, po ashtu përmes këtij Komisioni AKK-ja do të llojë për iniciimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Sesioni i 28-të i Kongresit të Autoriteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës

24-26 mars 2015 Strasburg, Francë - Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës mbajti sesionin e 28-të të Kongresit në Pallatin e Evropës.

Duke pasur parasysh se Asociacioni i Komunave të Kosovës mban statusin e vëzhguesit në Kongres, kryetari i AKK-së, z. Naim Ismajli dhe zëvendës kryetari i AKK-së Z. Agim Veliu, anëtar i Bordit të AKK-së z. Svetislav Ivanović dhe Drejtor Ekzekutiv i AKK-së z. Sazan Ibrahimović u ftuan për të marrë pjesë në këtë seancë. Tema e dy sesioneve të këtij viti ishin: Reagimet lokale ndaj sfidave të të drejtave të njeriut - migracioni, diskriminimi, përfshirja sociale dhe disa debate ishin të përkushtuar për këtë temë si dhe debate mbi reagimet e radikalizmit në qytete dhe rajone të Evropës.

LAJME NGA KOMUNAT

Marrëveshje për avancimin e turizmit alternativ në Podujevë

Kryetari i Komunës së Podujevës, z. Agim Veliu, ka pritur në një takim kryetarin e Shoqatës së Turizmit Alternativ të Kosovës (SHTAK), z. Baki Hoti, me të cilin ka nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi mes SHTAK dhe Komunës së Podujevës. Nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje kryetari Veliu e ka vlerësuar si shumë të rëndësishme, meqë komuna e Podujevës ka një potencial të pasur natyror për zhvillimin e turizmit rural. Duke pasur parasysh rolin e zhvillimit të hovshëm dhe rëndësinë që ka turizmi në ekonominë e Kosovës, në takim u potencua se shkëmbimi i përvojave do të ketë një rëndësi shumë të madhe për sektorin e turizmit edhe në komunën e Podujevës. Marrëveshja e nënshkruar parasheh iniciimin e bashkëpunimit në sektorin e turizmit dhe shkëmbimin e përvojave; bashkëpunimi në projektet me interes të përbashkët; stimulimi i turistëve për ta vizituar Komunën e Podujevës; përpilimin e materialeve të marketingut; shkëmbimi i materialeve promovuese dhe përfshirja e Podujevës në paketat turistike.



Në Klinë punohet për kthimin dhe riintegrimi në Kosovë

Nën organizimin e Zyrës Komunale për Kthim të Komunës së Klinës, u mbajt takimi i dytë me radhë i Task Forcë-s për projektin e BE-së Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë. Nga 8 rastet e miratuara, 4 janë familje të zhvendosura të komunitetit Serb të cilat do të kthehen në pronat e tyre private, ndërsa 4 tjerat që i takojnë komunitetit RAE do të kthehen në fshatin Klinafç në lokacionin në pronësi të Komunës së Klinës ku më herët janë kthyer 12 familje tjera RAE. Projekti Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë, financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare e Migrimit-IOM. Qëllimi i projektit është ofrimi i kushteve për kthim dhe riintegrim për 150 familje të zhvendosura dhe përfshin 7 komuna të Kosovës.

Kolegjiumet e AKK-së në periudhën Mars / Prill

Rezultati kryesor i arritur sa i përket periudhës janar – mars 2015, janë takimet së pari me kryesitë e kolegjiemeve veç e veç, e pastaj me secilin kolegjiu veç e veç, rreth hartimit të planeve vjetore të punës. Pra, gjatë kësaj periudhe, rezultati i arritur është hartimi dhe aprovimi i 12 planeve të punës për secilin Kolegjiu të AKK-së.

Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave

Në takimin e organizuar nga Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave me qëllim kryesor hartimin e planit të punës si dhe koordinimin e përgjegjësisë në realizimin e aktiviteteve të Kolegjiut me objektivin e qartë, rritjen e rolit të Kuvendeve të Komunave në Qeverisje Lokale. Po ashtu një pikë e rëndësishme u konsiderua edhe shqyrtimi i strategjisë legjislative të qeverisë së Kosovës në përcaktimin ligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare me theks të veçantë projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Në funksion të përmirësimit të punës të Kuvendeve të Komunave, Kolegjiumi i Kryesuesve kërkoi vazhdimin e konsultimeve me Ministrinë e linjës lidhur me sqarimin e pozitës dhe adresimin e kërkesës për rritje të pagesës së këshilltarëve komunal. Edhe gjatë këtij takimi Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave ka shprehur kërkesën lidhur me rritjen e mëditjeve e anëtarëve të Kuvendeve Komunale, si vendim që do të ndikoj në performancën dhe efikasitetin më të madh të punës së Kuvendeve të Komunave.

Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor

Takimi u organizua si vazhdim i takimit nga kryesia e kolegjiut në përgatitjen e planit të punës dhe diskutimin e prioritetëve, si dhe koordinimin e përgjegjësisë në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiut. Qëllimi kryesor i takimit ishte aprovimi i planit të punës, si dhe shqyrtimi së bashku i strategjisë legjislative të qeverisë së Kosovës në përcaktimin ligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare.

Njëra ndër kërkesat kryesore të kolegjiut për planifikim hapësinor mbetet diskutimi dhe rishqyrtimi i legjislacionit i cili rregullon planifikimin hapësinor në komuna për shkak të mungesës së udhëzimeve administrative në rregullimin dhe sqarimin e problematikave konkrete në teren. Bashkëpunimi në mes të Kolegjiut për Planifikim Hapësinor dhe Ministrisë së Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor vlerësohet të jetë hallka kryesore në tejkalimin e këtyre problematikave në fushën e ndërtimit dhe në mënyrë specifike gjetjen e zgjidhjes afatgjatë të trajtimit të ndërtimeve pa leje në territorin e Kosovës.

Kolegjiumi për Shërbime Publike

Kolegjiumi i Shërbimeve Publike në takimin e saj miratoi planin e saj të punës në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve si dhe shqyrtoi strategjinë legjislative në përcaktimin ligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare.

Një rol i fuqishëm do të jetë edhe konsolidimi i veprimeve me synimin e qartë rritjen e kapaciteteve të saj për një periudhë të ardhshme në aspektin organizativ si dhe në funksion të përfaqësimit dhe mbrojtjes sa më të mirë të interesave komunale në rend të parë shërbimet komunale, përfshirë edhe furnizimin me ujë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta (urbane), rrugët, dhe shfrytëzimin eficient të energjisë etj. Po ashtu në takim u prezantua edhe Projekti Skema Beacon një nismë e AKK-së në bashkëpunim me GIZ-in i cili synon përdorimin e tanishëm të praktikave/performancave më të mira të komunave të Kosovës duke i përhapur ato në komunat tjera. Përveç kësaj, projekti ka tendencën të nxisë risi dhe të rrisë performancat aktuale të nivelit lokal me qëllim krijimin e një platformë të qëndrueshme të shkëmbimit të praktikave më të mira në mesin e komunave, të shpërblej komunat me performancë më të mirë, si dhe të zhvillojnë një grup efikas të mjeteve të menaxhimit të njohurive që do të zbatohen nga komunat e shpërblyera.



Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa

Kolegjiumi për buxhet dhe financa organizoi takimin e rregullt me qëllim përgatitjen e planit të punës dhe diskutimin e prioriteteve në fushën e financave lokale si dhe koordinimin e përgjegjësive në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiumit si dhe shqyrtimin e strategjisë legjislative në përcaktimin ligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare në mënyrë të veçantë plotësimi dhe ndryshimin i projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Njëra ndër sfidat kryesore të drejtorëve komunal mbetet çështja e shkurtimeve buxhetore në kategoritë e ndryshme, andaj edhe diskutimi duhet të përqendrohet në alokimin e mjeteve shtesë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Andaj koordinimi sa më i mirë i politikave financiare duhet të jetë parakusht drejt një bashkëpunimi më të ngushtë në mes të MF dhe Kolegjiumit për B&F.

Njëra ndër çështjet me shumë rëndësi mbetet edhe ai i faljes së borxheve publike deri më 31 dhjetor 2008, nismë kjo e Qeverisë së Kosovës e cila do të ketë ndikim shumë të madh në buxhetet komunale. Përkundër vërejtjeve të tyre lidhur me këtë iniciativë duke konsideruar si jo të drejtë ndaj të gjitha atyre paguesve të ndërgjegjshëm, kolegjiumi për buxhet dhe financa kërkoi nga AKK-ja të adresoi këtë çështje tek MF me kërkesë specifike që nëse një projektligj i tillë të kalojë në qeverinë e Kosovës, të ketë kushtëzime në pagesat e obligimeve të prapambetura nga 1 janari 2009 e deri në ditët e sotme. Po ashtu me shumë rëndësi u konsiderua përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe raportimit në mes drejtorive komunale për buxhet dhe financa dhe, departamentit për buxhetet komunale, tatimit në pronë dhe thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave.

Kolegjiumi për Integritet Evropiane

Kolegjiumi për Integritet evropiane në vazhdim të punës dhe aktiviteteve të saj ka hartuar planin vjetor të punës në përcaktimin e prioriteteve si dhe koordinimin e përgjegjësive në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiumit.

Në funksion të përmirësimit të punës dhe raportimit sa më të mirë të aktiviteteve komunale, Kolegjiumi i zyrtarëve komunal për Integritet Evropiane në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal diskutoi edhe propozimin e formatit të raportimit lidhur me indikatorët sa i përket raportit të progresit. Po ashtu në vazhdimësi të këtij aktiviteti do të jenë edhe vizitat që do të ndërmarrë MAPL-ja në komunat e Kosovës lidhur me sqarimin e përmirësimin e raportimit në përmbushjen e obligimeve të cilat dalin nga Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit -(PVN-

MSA). Njëra ndër shqetësimet aktuale të kolegjiumit ende mbetet funksionalizimi i zyrave komunale për integritet evropiane në respektim të vendimit kryeministrit 08/2011 për themelimin e zyrave komunale për integritet evropiane dhe funksionimin e tyre sa i përket raportimit të detyrave të cilat kryejnë komunat në përmbushje të standardeve të kërkuara nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA).



Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kolegjiumi për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në vazhdim të aktiviteteve të saj, mbajti takimin e saj në rishikimin e planit të punës në përcaktimin e prioriteteve, realizimin e objektivave e aktiviteteve të punës në të ardhmen, si dhe shqyrtimin e strategjisë legjislative për diskutimin e iniciativave ligjore në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale me interes për komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare.

Duke marrë parasysh ndryshimet e fundit në përbërjen e Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale anëtarët e Kolegjiumit vendosën në mënyrë të përbashkët që zëvendësimi për pozitën e zv. kryesuesit të Kolegjiumit nga znj. Labinote Demi të kalohet tek z. Burim Karameta drejtor për shëndetësi dhe mirëqenie sociale nga komuna Ferizaj në vazhdimin e punës dhe aktiviteteve në të ardhmen e Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Po ashtu në funksion të bashkëpunimit të ngushtë në fushën e mirëqenies sociale, kolegjiumi konfirmoi edhe një herë mbështetjen për organizatën Amici dei Bambini në bashkëfinancimin dhe ndihmën e saj profesionale sa i përket strehimit familjar, dhe parandalimin e braktisjes së fëmijëve. Marrë parasysh problematikat që kanë komunat kanë në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kolegjiumi konsideroi se duhet të ketë një bashkëpunim më të madh e më të hapur me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Punës e Mirëqenies Sociale në mënyrë përmirësimit sistemit të përgjithshëm shëndetësor dhe shërbimeve të mirëqenies sociale në komuna.

Kolegjiumi për Arsim

Qëllimi kryesor i takimit ishte aprovimi i planit të punës, diskutimi i prioriteteve, si dhe koordinimi i përgjegjësive në realizmin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe shqyrtimi së bashku i strategjisë legjislative të qeverisë së Kosovës në përcaktimin ligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare. Edhe një herë anëtarët e kolegjiumit shprehën nevojën e avancimit të kornizës ligjore, ku në diskutimet e tyre ngritën çështjen e rregullimit të koeficientit unik për mënyrën e gradimit të punonjësve të arsimit, përshtatjen e formulës së financimit, shkallëzimi i pagave sipas vlerësimit me kritere dhe matje të performancës, si dhe rregullimin më të mirë të çështjes së pensionimit të punëtorëve arsimor. Po ashtu u kërkua të bëhet rishqyrtimi i formulës së financimit në përcaktimin e kriterëve të planifikimit buxhetor për drejtoritë komunale të arsimit.



Kolegjiumi për Administratë

Takimi u organizua si vazhdim i punës së kolegjiumit në diskutimin e prioriteteve, si dhe koordinimin e përgjegjësive në realizmin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiumit për Administratë. Qëllimi kryesor i takimit ishte aprovimi i planit të punës, si dhe shqyrtimi së bashku i strategjisë legjislative të qeverisë së Kosovës në përcaktimin ligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare.

Kolegjiumi konsideroi se qëllimi kryesor mbetet përmirësimi i shërbimeve administrative në komuna proces ky i cili nuk mund të ketë sukses pa një koordinim më të mirë së bashku me ministritë e linjës pasi një gjë e tillë mungon, andaj bashkëpunimi dhe diskutimi i këtyre problematikave me komunat duhet të jetë kriter në përmirësimin e mëtutjeshëm të shërbimeve për qytetarët. Njëra ndër sfidat mbetet harmonizimi i ligjeve në përputhje me kompetencat komunale në fushën administrative, përmirësimi i mirëmbajtjes së sistemit të intranetit si dhe procesi i sistemit të digjitalizimit të librave amzë e po ashtu furnizimi me kohë i komunave me certifikata dhe ekstrakte. Shkëmbimi i praktikave të mira mund të jetë një shembull i mirë në fushën e bashkëpunimit komunal sikurse është ai i sistemit të menaxhimit të radhës apo regjistrimi

automatik i kërkesave të qytetarëve të cilat zbatohen me sukses në komuna të caktuara.

Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik Lokal

Duke marrë parasysh ndryshimet e fundit në përbërjen e Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe zëvendësimin e kryesuesit të deritanishëm z. Dardan Sejdiu u.d i drejtorisë për zhvillim ekonomik në komunën e Prishtinës, anëtarët e Kolegjiumit të Zhvillimit Ekonomik Lokal vendosën në mënyrë të përbashkët që pozita e Kryesuesit të Kolegjiumit të kalohet tek z. Bashota drejtor nga komuna e Prishtinës dhe vazhdimin e punës së deritanishme në realizimin e aktiviteteve të Kolegjiumit për ZHEL në të ardhmen. Në përmbushje të objektivave të saj Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik Lokal po ashtu hartoi planin e punës në përcaktimin e prioriteteve, si dhe koordinimin e përgjegjësive në realizmin e aktiviteteve të saj, si dhe shqyrtimi i strategjisë legjislative të qeverisë së Kosovës në përcaktimin projektligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare. Si rrjedhojë, ky plan do të jetë edhe pikë nisje për hapat e mëtutjeshëm për aktivitetet të cilat do të vijnë gjatë zbatimit të programit nga Kolegjiumi në përmirësimin e zhvillimit ekonomik lokal ekzistues dhe ndërtimin e praktikave të reja brenda komunave, në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin ekonomik, po ashtu një rol më të fuqishëm dhe dinamik për komunat në promovimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Kolegjium për Inspeksion

Duke marrë parasysh tendencat e deritanishme në centralizimin e kompetencave të inspektorëve në komuna nga niveli qendror dhe dilemën nëse në komuna duhet të funksionojë një drejtori e tillë, Kolegjiumi për Inspeksion konsideroi se synimi kryesor duhet të jetë lobimi tek institucionet qendrore në rregullimin e veprimtarisë inspektuese në komuna dhe rikthimin e kompetencave të centralizuara të inspektorëve të fushave të ndryshme. Edhe përkundër faktit se kolegjiumi është në vazhdim të lobimit në rikthimin e kompetencave të inspektorëve të tregut nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ku janë dhënë edhe disa sinjale nga MTI-ja për rishikimin e këtij vendimi duke marrë parasysh problemet në teren dhe koston e lartë financiare në mos zbatimin e këtij ligji që nga miratimi i tij në vitin 2012 dhe ende jo funksional sot e kësaj dite.

Me këtë rast pas shqyrtimit edhe këtë vit drejtorët komunal për inspeksion miratuan planin e punës 2015 në përcaktimin e prioriteteve, si dhe koordinimin e përgjegjësive në realizmin e objektivave dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe shqyrtimi i strategjisë legjislative të qeverisë së Kosovës në përcaktimin projektligjeve me interes për diskutim nga komunat në grupet punuese qeveritare dhe ndërqeveritare.

LAJME NGA KOMUNAT



Kryeqendrat evropiane model për zhvillimin e Komunës së Prishtinës

Drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Arbërie Nagavci me delegacionin komunal vizituan shkollat e qytetit të Gracit të Austrisë me qëllim që të informohen rreth digjitalizimit të shkollave, si dhe përvojën të cilën e ka Austria me digjitalizimin e administratës së shkollave.

Me këtë rast, delegacioni nga Komuna e Prishtinës e vizitoi shkollën publike "Graz International Bilingual School" (GIBS) ku me udhëheqësit e shkollës u diskutua lidhur me vështirësitë dhe përparësitë e aplikimit të projektit të digjitalizimit. Gjatë kësaj vizite u diskutuan edhe çështjet lidhur me qëndrimin tërë ditë në shkollë, funksionimin e çerdheve publike dhe atyre private, si dhe për ligat sportive në shkollë dhe bashkëpunimin e tyre me shoqatat e sportit. Drejtorja Komunale e Arsimit të Komunës së Prishtinës ka për synim digjitalizimin e administratës nëpër shkollat e kryeqytetit me qëllim të përmirësimit të procesit edukativ - arsimor.

Fillon fushata "PYT" (Komunën e Gjakovës)

Gjatë kësaj fushate qytetarët do të ftohen për të bërë pyetje për komunën e tyre, përkatësisht komunën e Gjakovës, përmes një kamere e cila do të vendoset në qendër të qytetit. Ka filluar aktiviteti katër ditë i quajtur "PYT" (komunën tende);

njëra ndër aktivitetet e shumta të implementuara në kuadër të projektit të UNDP-së, Mbështetja e Përpjekjeve Kundër Korrupsionit në Kosovë në bashkëpunim me komunën e Gjakovës.

Pas kësaj, zyrtarët përkatës të komunës do të përgjigjen për pyetjet e bëra po ashtu përmes videos – mirëpo prej zyreve të tyre. Një version i edituar i videos me pyetje dhe përgjigje do të transmetohen në stacionet e medias lokale, uebfaqet komunal dhe uebfaqen të UNDP-së.

Kërkesë në Gjilani për linjë të veçantë buxhetore për kontrollimin sistematik të nxënësve

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (KSHMS) ka miratuar raportin e punës së Drejtorisë së linjës, për periudhën janar-mars 2015, të cilin e ka prezantuar drejtori Muhamet Kastrati, përfshirë edhe raportin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), që e ka paraqitur drejtori Fejzullah Berisha, ndërkohë që është informuar edhe për ecurinë e vaksinimit të fëmijëve, nga shefi i Shërbimit, Ismet Uruqi. Jashar Jashari, kryesues i kësaj trupe komunale, ka thënë se KSHMS ka kërkuar linjë të veçantë buxhetore për projektin e kontrollit sistematik të nxënësve, pastaj sigurimin e një mbështetje financiare për strehimoren "Liria" si dhe shqyrtimin e mundësive për marrjen e regjistrimit të fëmijëve të lindur brenda një viti, nga Administrata e përgjithshme, për nevoja të vaksinimit. Njëherësh, Jashari e ka përgëzuar Shërbimin e vaksinimit për punën e mirë që është duke e bërë, me një përfshirje prej 95 për qind të fëmijëve në programin e imunizimit nga sëmundjet ngjitëse, ndërkaq sa u përket nxënësve të cilët diagnostifikohen me sëmundje të ndryshme, ka rekomanduar që të udhëzohen tutje rastet që nuk mund të trajtohen në QKMF.

Vushtrria së shpejti me Qendrën për Grumbullimin e Paketimin e Materialeve të Riciklueshme



Kanë filluar filluar punimet në ndërtimin e Qendrës për Grumbullimin e Paketimin e Materialeve të riciklueshme në fshatin Bukosh të Vushtrrisë.

Kryetari i Komunës, Bajram Mulaku, duke i përgëzuar investitorët për ndërtimin e këtij projekti, ka thënë se ky është një objekt shumë i rëndësishëm dhe shumë dimensional për Komunën, kurse në rënd të parë krijon kushte për një ambient të pastër.

Në solemnitetin e organizuar me këtë rast, ku merrnin pjesë përfaqësuesja e RDA-Veri, Rreze Duli dhe Koordinatori i projektit nga Kompania REA e Prishtinës, Ahmet Jetullahu – Meti, u tha se punimet në ndërtimin e tij do të zgjasin për afërsisht dy vjet, kurse investitor është Komisioni i BE.

Islam Latifi, zyrtar nga Drejtorja e Shërbimeve Publike tha se ky projekt synon themelimin e ndërrmarjes sociale, e cila do të administrojë këtë qendër që do të bëjë grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme, ku do të përfshihen metalet, plastika, letra, etj. Sipas Jetullahut, kjo qendër do të ketë makineritë e nevojshme për sortim, presim e paketim, dy kamioneta për grumbullim si dhe do të vendosen 100 kontejnerë në pika të ndryshme, e sidomos aty ku ka koncentrim më të madhë të mbeturinave të riciklueshme“.

Trajnim mbi financat publike komunale për komunitat partnere të Helvetas Swiss Intercooperation / projektit DEMOS



Projekti DEMOS ka zhvilluar një trajnim lidhur me çështjet buxhetore dhe financiare si dhe mjetet dhe instrumentet për të siguruar një mbikëqyrje financiare të ekzekutivit nga këshilltarët komunal, për 17 komunitat partnere . Trajnimi është zhvilluar gjatë muajve mars dhe prill. Përveç trajnimit, projekti do të zhvilloj edhe një manual për menaxhim dhe mbikëqyrje financiare që do të ndihmojë këshilltarët komunal në ushtrimin e funksionit të tyre këshilltar komunal dhe të kontrollojnë ekzekutivin për menaxhimin e financave publike.

Inventarizimi i hapësirave të hapura publike në 10 komunitat e Kosovës nga projekti DEMOS

Projekti DEMOS, komponenta e shërbimeve publike konkretisht fusha e Hapësirave të Hapura Publike (HHP) që nga java e fundit e janarit dhe përgjatë muajit shkurt 2015 ka angazhuar eksperte vendor të cilët kanë bërë analizën e gjendjes ekzistuese dhe të nevojave për hapësirat e hapura publike në 10 nga gjithsej 17 komunitat partnere të projektit DEMOS të cilët kanë përzgjedhur këtë fushë. Analiza dhe rezultati i nxjerr nga raporti ka rezultuar me organizimin e misionit të parë pesë ditor me ekspertë ndërkombëtar dhe vendor në përpilimin e programit për trajnime për komunitat.

Trajnimi i parë u mbajt me 26

Mars 2015 në Prishtinë me temën “Prezantimi i të gjeturave nga vizitat në terren dhe pyetësori” i plotësuar nga komunitat për situatën ekzistuese të hapësirave publike në 10 komunitat respektive.

Ekspertët lokal dhe ndërkombëtar prezantuan Raportin e vlerësimit të nevojave të 10 komunave dhe në bashkëpunim me pjesëmarrësitë identifikuan gjashtë fushat konkrete të cilat komunitat i priorizuan për t’u mbështetur nga projekti DEMOS në tre vitet e ardhshme, përmes përpilimit të një programi trajnimesh bazuar në nevojat dhe kërkesat e tyre në fushën e hapësirave publike.

Programi i trajnimit i zhvilluar në këtë fazë ka pasur me organizimin e një punëtorie më datën 28 prill 2015 në Lipjan për “Inventarizimin e hapësirave të hapura publike”. Pjesëmarrësit përfaqësues të 10 komunave u trajnuan në programin QGIS, softëer ku përmes së cilës komunitat do të krijojnë një bazë të të dhënave të inventarizimit të të gjitha hapësirave të hapura publike në pronësi komunale. Ky inventarizim pritet të përfundoj deri në fund të muajit maj i mbështetur më pas me përpilimin e Planeve të Mirëmbajtjes së HHP për 5 komunitat e para më të interesuara që të nisin me përpilimin e këtij plani në vitin 2015.



Eko-miku – mekanizëm novativ për t'i financuar klubet e gjelbra nëpër shkolla



Planifikimi i menaxhimit të integruar të mbeturinave të ngurta

Qëllimi i këtyre projekteve është që të mbështetet zhvillimi i mëtejshëm i një mekanizmi për financim të qëndrueshëm, që quhet “Eko-miku”, për aktivitetet e klubeve të gjelbra që aktualisht janë duke u zhvilluar në 42 shkolla të Prishtinës dhe në shkollat e tjera të komunave të tjera. Koncepti i eko-mikut është dizajnuar dhe iniciuar nga Green Art Center – Prishtina (GAC), me mbështetjen e Ambasadës Finlandeze në Kosovë, si pilot projekt, dhe është avancuar me mbështetjen e GIZ-së në zhvillimin e mëtejshëm të këtij mekanizmi në kuadër të projektit “Prishtina Riciklon”. Qëllimi përfundimtar i mekanizmit eko-miku është që gjenerata e re të edukohet dhe të vetëdijësohet për mjedisin. Ideja e këtij mekanizmi financiar është që të fillojë ndarja e mbeturinave të riciklueshme nëpër shkolla. Materialet burimore pastaj mbledhen nga kompanitë private që paguajnë për mbeturinat e riciklueshme me çmim të tregut në një eko-fond, i cili pastaj përdoret për t'i mbështetur aktivitetet e klubeve të gjelbra nëpër shkollat publike. Këto klube përbëhen nga vullnetarë që organizojnë aktivitete për t'i nxitur nxënësit dhe anëtarët e tjerë të stafit që t'i ndajnë mbeturinat dhe ta mbrojnë mjedisin, hapësirat e gjelbra dhe jetën në komunitet. Veç kësaj, ky projekt mund ta shtojë edhe vetëdijësimin në komunitet, sepse nxënësit i përhapin njohuritë që i kanë fituar në shkollë nëpër shtëpitë e tyre.

Këtë projekt e realizon GAC-ja, me mbështetjen e GIZ-së.

Procesi - Ky projekt përfshin aftësimin e stafit të shkollave dhe të nxënësve për t'i menaxhuar dhe ndarë mbeturinat. Në secilën klasë, nëpër korridore dhe nëpër oborret e shkollave vendosen kontejnerë me ngjyra për mbeturinat e ndara: për plastikë, për letër dhe për alumin. Një kompani private që përzgjidhet nga komuna i mbledh mbeturinat dhe paguan me çmimi të tregut në eko-fondin që e menaxhon GAC-ja. Në këtë mënyrë sigurohet qëndrueshmëria e procesit.

Pilot projektet - Komuna e Prishtinës dhe ajo e Pejës tashmë i kanë filluar aktivitetet. Stafi dhe nxënësit po marrin pjesë në aktivitetet e vetëdijësimi dhe po i ndajnë mbeturinat. Infrastruktura për ndarjen e mbeturinave është prokuruar. Pritet që edhe komuna e Gjilanit dhe ajo e Mitrovicës t'i fillojnë aktivitetet së shpejti. / www.mjedisi.com/ecofriend



GIZ-ja po i mbështet komunat partnere në rishikimin dhe hartimin e planeve për menaxhimin pjesëmarrës dhe të integruar të mbeturinave të ngurta, në përputhje me obligimet ligjore të tyre që janë definuar në Ligjin kombëtar për Mbeturinat (të vitit 2012).

Procesi - Planet hartohen sipas procedurave që janë përvijuar në “Manualin për Planifikimin e Menaxhimit të Mbeturinave në Nivel Lokal*”. Hapi i parë është krijimi i grupeve punuese aktive nëpër komuna. Së dyti, bëhet një vlerësim themelor për të mbledhur të dhëna për aspektet financiare, teknike, ekonomike, mjedisore, sociale, ligjore dhe institucionale të sistemit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta. Komunat partnere tashmë i kanë arritur këta dy hapa të parë. Një punëtori fillestar është mbajtur në fund të prillit të vitit 2015, për ta filluar hartimin e planeve. Në këtë punëtori janë konsoliduar, skanuar dhe analizuar të gjitha të dhënat. Hapi i ardhshëm është shtjellimi i Planit të Punës për Mbeturinat e Ngurta, në të cilin definohen nevojat dhe prioritetet, caktohen qëllimet dhe objektivat dhe planifikohen aspektet teknike. Pas kësaj, në Planin Financiar për Mbeturinat e Ngurta do të përcaktohen strukturat financiare, duke u bazuar në analizën e shpenzimeve dhe të hyrave të shërbimit aktual, në investimet kapitale në dispozicion dhe të projektuara dhe në politikën tarifore. Më në fund shtjellohet Plani i Veprimtimit për Mbeturinat e Ngurta, në të cilin përpilohet një udhëzues për aktivitetet, aktorët, planin kohor dhe buxhetin. Përfundimisht, kuvendi komunal duhet ta aprovojë PMMN-në, ndërsa organet komunale duhet t'i realizojnë aktivitetet e parapara.

Rezultatet e pritura - Duke e planifikuar dhe përmirësuar performancën e menaxhimit të mbeturinave, komunat e Kosovës fuqizohen që ta vënë në veprim një sistem të menaxhimit të integruar dhe të qëndrueshëm të mbeturinave të ngurta.

*Decentralizimi dhe Programi për Zhvillim Lokal (DPZHL), Helvetas Swiss Intercooperation, Shqipëri: Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave në Nivel Lokal (2012)



Kryetarë të Komunave në Ekspozitën Ndërkombëtare të Planifikimit të Qytetit dhe Teknologjisë

13 Kryetarë të Komunave të Republikës së Kosovës dhe Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës u ftuan nga Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Stamboll në Ekspozitën e 5-të Ndërkombëtare të Planifikimit të Qytetit dhe Teknologjisë.

Aktivitet e Ekspozitës së Qytetit ishin: - Simpoziumi i 4-të i Qeverisjes Lokale i cili u mbajt në bashkëpunim me Unionin e Komunave të Turqisë dhe Unionit të Komunave të Mesdheut u zhvillua paralelisht me ekspozitën. Simpoziumi, u ndjek nga



rreth 1000 njerëz, duke përfshirë shumë kryetarë dhe Drejtues të Lartë, dhe u diskutua rreth Transportit. - Takimi rajonal i Federatës Coacher të Turqisë (TOFED), i cili përfshinte rreth 72

Asociacione në 8 drejtori rajonale rreth Turqisë, për herë të dytë mbajti takimin e tij rajonal në Anfas City Expo. Më vonë, delegacioni vizitoi panairin dhe u informua rreth teknologjive të reja.

Shkurtimisht

■ Përfaqësuesit e AKK-së morën pjesë në takimin e grupit punues për plotësim-ndryshimin e Rregullores mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike dhe pjesëmarrja e komunave në Bordin e Drejtorëve në Ndërmarrjet Rajonale të ujit.

■ Përfaqësuesi i AKK-së, është anëtar në grupin punues për hartimin e "Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e përmbajtjes, mënyrës dhe procedurat e programit për mbrojtjen e veprimeve të dëmshme të ujërave".

■ Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në debatin publik - të organizuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve lidhur me Projektligjin për trashëgimi kulturore.

■ Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin e rregullt të Këshillit të Turizimit të Kosovës.

■ Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin e organizuar nga MAP-ja, Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil - diskutimi rreth kategorizimit të vendeve të punës, ku përfaqësuesi i AKK-së paraqiti të gjitha vërejtjet rreth vendeve të punës që i përkasin nivelit lokal e që nuk janë kategorizuar si duhet dhe ato të cilat mungojnë, e ku u propozuan të shtohen mbi 30 pozita në nivelin lokal.

■ Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin në Ministrinë e Financave në temën "Decentralizimi fiskal".

■ Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në punëtorinë dy ditore e organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me mbështetjen financiare të OSBE-së, ku u shqyrtuan dy akte nënligjore: - "Projekt-rregullorja për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave" dhe "Projekt-udhëzimi administrativ për njësinë e administrimit të dokumenteve në komuna".

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti XII. Nr. 71 • Mars - Prill 2015

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

